



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

**Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture**  
**Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	20.12.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	23/3200/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Solar Tec 2" Sh.p.k. - Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot. : 23/3200/320/ DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë, për Impiantin Fotovoltaik 70.4 MWp në zonën kadastrale Gllanasellë, Drenas. "Solar Tec 2" Sh.p.k. Prishtinë

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë  
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/inmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the  
General Secretary*

---

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë “Solar Tec 2” Sh.p.k. Prishtinë, për Impiantin Fotovoltaik 70.4 MWp në zonën kadastrale Gllanasellë, Drenas, në parcelat P- 00185-4, P-00208-0, P-00209-0, P-01380-1, P-01380-3, P-00202-2 dhe P-00207-2.**



Faqe 2 nga 3

---

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë  
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)

## Ar sy e t i m

Gjatë shqyrtimit të Kërkesës për raportin e VNM-së si dhe dokumenteve përcjellëse të Kompanisë "Solar Tec 2" Sh.p.k. Prishtinë, me datën 26.06.2023, është konstatuar se mungojnë dokumentet si në vijim:

- Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim- informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal;
- Raporti i VNM-së duhet të hartohet në përputhje me ligjin Nr. 08/ L-181 për VNM;
- Certifikates se biznesit i mungojnë fletët;
- Kopjes së planit i mungojnë ngastrat;
- Certifikatës së pronësisë i mungojnë ngastrat

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Solar Tec 2" Sh.p.k. Prishtinë, me datën 26.06.2023 i është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të sjellura, me datën 31.07.2023, është konstatuar se mungon:

- Kontrata për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme e noterizuar.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Solar Tec 2" Sh.p.k. Prishtinë, me datën 31.07.2023 i është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Njoftimi për Debat Publik i është dërguar Kompanisë me datë 14.09.2023, pas konfirmimit nga kompania, Komisioni ka konfirmuar mbajtjen e Debatit Publik me datën 29.11.2023.

Pas mbajtjes së Debatit Publik, Komisioni ka konstatuar se Kompania në fjalë nuk e ka shpall Debatin Publik në gazetë ditore sipas Nenit 16, LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS, për Informim të publikut dhe pjesëmarrjes

Faqe 3 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr. 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)



në debat për raportin e VNM-së, së paku 30 ditë, nga dita e mbajtjes së Debatit Publik.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI propozon **Përfundimin e procedurës administrative** e kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë Kompanisë "Solar Tec 2" Sh.p.k. Prishtinë, për Impiantin Fotovoltaik 70.4 MWp në zonën kadastrale Gllanasellë, Drenas.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 23/3200/1- ZSP/ /23 datë: 20.12.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Drenasit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm  
të MMPHI

Faqe 4 nga 3